



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1139/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevc i anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa: Anr.1139/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, e paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

## A r s y e t i m

Me datë 14.11.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.1139/2021, të paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, kundër Sami Lushtakut, kryetar i degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Skenderaj, ku pretendohet se i njëjti përmes një postimi në rrjetin social Facebook në ditën e votimit, ka bërë thirrje që të dalin të votojnë kandidatin e PDK-së për Kryetar të Komunës së Vushtrrisë Ferit Idrizin. Gjithashtu theksojnë se postimi i tillë është bërë me datë 14.11.2021 në ditën e votimit mirëpo pas disa minutash është fshirë. Si dëshmi ka bashkangjitur foton e marrë nga platforma e rrjetit social facebook.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK e mohon se ka ndodhur shkelja e supozuar pasi që theksojnë se postimi në fjalë nuk është bërë nga Partia Demokratike e Kosovës dhe as nga Sami Lushtaku, por postimi është bërë nga një faqe e rreme që është përdorur nga rivalet politik për të dëmtuar. Gjithashtu theksojnë se subjekti i tyre politik në vazhdimësi nëpërmjet njoftimeve zyrtare kanë bërë thirrje për respektimin e LZP-së dhe të gjithë rregullave zgjedhore me zhvillimin e fushatës zgjedhore.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar ngase nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse e njëjta është postuar me datën 14 nëntor 2021, pasi që në kohën e testimit e njëjta nuk ka qenë e postuar dhe ka qenë jo aktive.

Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësi i supozuar me datë 14.11.2021, ka bërë postim në ditën e votimit me thirrje elektorale për të votuar në rrjetin social "Facebook".

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se postimi i shkelësit të supozuar është publikuar në ditën e votimit, edhe pse parashtuesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i pretenduar është postuar në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar ashtu siç pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1139/2021 më datë 15.11.2021



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.